

ARTUR SPANJOLLI
SHIJE ËNDRASH NË SIRTAR
ROMAN

BOTIMET TOENA

ARTUR SPANJOLLI

SHIJE ËNDRRASH NË SIRTAR

~ roman ~

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktore: Besa Vila

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Mirjana Madhi

ISBN: 9789928376930

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

*Roman i bazuar në ngjarje
të jetuara.*

Autori

I

Pasditeve e mbaja gjithmonë frymën në shkollë. Duke qenë se studioja në një shkollë muzike, ndërtesa rrinte hapur deri në orën shtatë të darkës, sepse nxënësit e muzikës u binin veglave muzikore në orare të caktuara, ndaj korridoret, sallat e studimit, gati gjithmonë e sidomos pasditeve, gumëzhinin nga zhurmat e pleksura dhe nga gjallëria e instrumenteve. Në dimër errësohej shpejt. Ndaj, kur binte nata dhe godina poshtë yjeve apo hënës së plotë shëmbëllente me një anije plot tinguj të kredhur në ujëra ëndrrash, atëherë nga dritaret me drita të ndezura dilnin me hov edhe tingujt e pianove, të violinave, obojeve dhe violonçelave. Gjithçka përzihej në një kor të çrregullt dhe pa harmoni, por ku ndihej gjallëria e nxënësve, të cilët plot zell ushtroheshin me instrumentet në rrugën e gjatë edhe të vështirë të artit muzikor. Mbrëmjeve gjithashtu silleshin përreth godinës edhe gjuetarët e vajzave të bukura të shkollës sonë, të cilët prisnin çastin kur ato dilnin pas studimit dhe i ndiqnin nga pas.

Ne, artistët e ardhshëm të penelit dhe të daltës, i kishim sallat tona në fund të korridorit. Në katin e dytë. Sipër palestrës kishin bërë një shtesë dhe na kishin ndërtuar disa dhoma të mëdha plot dritë, ku vizatonim, pikturonim dhe bënim skulptura.

Viti i tretë kishte filluar me të vërtetë keq për mua. Verën e fundit, e kisha kaluar tërë kohën në plazh. Kurse një vit më parë, ndërsa i tërë qyteti në vapën e gushtit përvëlues e kishte mbajtur frymën në plazh, unë e kisha harxhuar të gjithë kohën në sallën e skulpturës duke punuar vizatim me orë të zgjatura. Edhe gjatë pushimeve verore, shkolla rrinte hapur. Kisha punuar aq shumë vitin e kaluar, sa në fillimin e vitit të dytë shkollor isha bërë më i miri në grup. Nuk mendoja se kisha shumë talent, por me punë, vullnet dhe kokëfortësi, ia kisha arritur qëllimit. Aq shumë kisha bërë bujë në klasë me punët e mia shtatorin e vitit të kaluar, sa profesor Vili një ditë më kish tërhequr veçmas dhe, duke më përgëzuar për rezultatet e arritura, më tha “Kjo është prova që njeriu, po të punojë, arrin gjithçka! Bravo!” Pastaj më rrahu shpatullat me mirëdashje dhe shtoi “Dhe vazhdo kështu”.

Ndërsa verën e fundit pra, kishte ndodhur krejtësisht e kundërta e një viti më parë. Jo vetëm ia kisha varur fare punës, por kisha harruar edhe ato pak gjëra që kisha përvetësuar falë përpjekjeve të mëdha, provë e cila vërtetonte se, nëse e lije artin, ai të linte. Gjatë tre muajve në plazh, ndërkohë që e kisha braktisur fare dosjen e vizatimit, jo vetëm isha nxirë i tëri nga dielli i pamëshirshëm, por edhe kisha rënë kokë e këmbë në dashuri me një vajzë. “Propozoji!”, më thoshte daja, i cili dinte më shumë sesa unë në punë dashurie. Bënim xhiro të gjata mbrëmjeve duke shkuar deri te hotel “Vollga”. E ndiqnim Entelën deri te shtëpia, duke ecur pak hapa prapa saj. Dhe ajo e dinte, sepse shpesh, tek bënte xhiron e mbrëmjes me shoqet e saj, kthente kokën e bukur dhe më buzëqeshte. “Nuk e kam të lehtë!”, ia ktheja unë dajës. “Më rreh zemra fort!”

“Ndaloje dhe propozoji! Mos u bëj trap! Ajo e ka shtëpinë nëpër rrugica. Nuk të sheh asnjëri në atë orë të vonë!” U mundova disa herë në errësirën e verës, plot heshtje dhe këngë bulkthash, ta ndaloja dhe t’i dilja në temë. Por ende shumë i ri në punë dashurie, nuk arrija të shpreheshja, ajo veç ndalonte dhe flisnim si shokë plazhi. Sesi më dukej vetja. Si Don Kishot, po t’i dilja në temë. Gjërat duhej të vinin rrjedhshëm, natyrshëm, jo ashtu. Por asaj kohe, vajzat, të ndrydhura nga mentaliteti, një koncentrat sa feudal aq edhe komunist, jo vetëm ruheshin nga gojë të botës, por kishin gjithashtu nevojë për një mashkull guximtar që t’i shkante punës deri në fund. T’i propozonte, pra, fare pa frikë.

Por atë shtator ajo filloi studimet tek universiteti “Luigj Gurakuqi” në Shkodër dhe brenda meje u krijua një boshllëk, një zbrazëti e ëmbël dashurie, gati e pashpjegueshme, por shumë e natyrshme. Malli më mundonte aq shumë, sa tashmë e kisha humbur fare toruan dhe nuk isha në gjendje as të sfumoja një hije për të qenë me laps, në letrën e vizatimit. Ishte epoka kur këngët si “Take my breath away” dhe “True color” kishin pushtuar jo vetëm tregjet e Europës, por së pari kishin pushtuar tërësisht botën time të brendshme. “Ç’të ka ndodhur?! - Habitej profesori im i skulpturës, Iliazi. - Ti vjet në shtator ishe më i miri!”

Unë rrija në heshtje me mallin që më përvëlonte shpirtin. Gjithkund në ndërgjegjen time, gjeje veç emrin e saj, fletë të tëra të shkruara plot dhe kujtime vere plot dritë, të cilat tani iknin larg e më larg.

“Duket sikur të kanë marrë më sysh. Kur thonë plakati!”, më thoshte ai. Shokët e grupit: Nini, Marini, Veshtullori

dhe Jari rrinin në heshtje. “Ka rënë në dashuri!”, ishte shprehur një shok i klasës, me zërin e tij të ndrojtur, por duke buzëqeshur me dashamirësi. E kish thënë, ndërsa modelonte me baltën e butë një profil skulpture në relief. Ishim te salla e skulpturës. “Përse thua marrëzira?!”, i isha kthyer unë, duke mohuar nga turpi dhe sedra e madhe. Por e vërteta qëndronte tamam ashtu siç pohonte shoku i grupit nga Syneji. Kish qenë dashuria në plazh, pra, arsyeja kryesore e hardallosjes sime. E kisha mendjen e shpërndarë si zhiva mbi dysHEME, kur thyhej termometri.

Në atë fund vjeshte, me shumë lodhje po mundohesha ta mblidhja veten. Pasditeve shkoja përditë në shkollë me mendjen te puna. Pasi haja bukë në shtëpi, merrja dosjen e vizatimit, lapsat, gomën, zbrisja shkallët e pallatit, kaloja sheshin e stacionit të trenit dhe i futesha rrugës së stacionit të vjetër të trenit. Tek ecja në orën dy, shihja të njëjtat ndërtesa italiane, të njëjtat fytyra njerëzish, të njëjtat hije pemësh. Të njëjlojtën dritë të kursyer rrugicash të vjetra në tetor. Ishin rrugica njëqindveçare, me shtëpi të cilat e kishin kaluar shekullin. Kishin parë botë me sy. Rrugica karakteristike përbri detit dhe portit, një pjesë e të cilave ndërtoar edhe përpara se të vinin italianët. Një pjesë e tyre kishin qenë aty kur ishin shpërrur turqit. Edhe kur kishte ardhur princi austriak, ato kishin qenë aty. Po aty gjatë mësymjes së shtatë prillit dhe po prapë aty kur komunistët kishin marshuar triumfues drejt kryeqendrës, Tiranës. Rrugica me dritare të vjetra, me mure hijerënda që nuk plakeshin kurrë. Rrugica që çlironin një aromë deti dhe leshteriku. Rrugica që u vinte era tregti, ku ende shquheshin

hijet e zonjave të rënda, të cilat zbrisnin nga anijet tregtare të portit veshur plot salltanet dhe bizhu. Ende dalloheshin edhe dyqanet apo zyrat, ku ishin nënshkruar kontrata, bërë marrëveshje tregtare, muret e të cilave mbanin dhe ndrynin aq shumë histori. Ai ishte Durrësi më i vjetër dhe që më intrigonte më shumë sesa gjithçka.

Pas dhjetë minutash rrugë mes lagjes së vjetër të portit, gjendesha gjithmonë te dera e shkollës së muzikës. Kur shkëlja oborrit e ndërtesës, rrethuar me gjelbërim, hapja derën e hyrjes dhe ngjisja shkallët në heshtje, ndërkohë që violinat, pianot dhe trombonët thyenin përjetësisht heshtjen e orëve të pasdites. E mbaja gjithmonë frymën te klasa e skulpturës. Aty, në vetminë e pasdites, ushtrohesh në mjeshtërinë e vizatimit. Kërkoja ta merrja veten nga hardallosja verore, edhe pse në atë kohë dija veç të vizatoja profilin e Entelës me hundën majuce.

Në fillim të nëntorit fillova të përmirësohesha. Pak nga pak, ai mall gërryes ngjyrë hiri, filloi të më linte të qetë dhe ndërgjegjja ime, më parë mbushur me muzikë dashurie, po rifitonte lirinë e humbur. Tashmë nuk rrija më me orë të tëra i shtrirë, duke dëgjuar muzikë ngushëlluese, ndërkohë që malli krijonte veç fantazma në breg të detit mes Hekurudhës dhe Ilirisë. Tashmë atje kabinat ishin të zbrazura, dyert të mbyllura me zinxhirë dhe me dryna të ndryshkur, rëra ishte e lagësht dhe frynte fort era e vjeshtës. Gjithkund atje kishte braktisje, harresë dhe gjethet e verdha të vjeshtës kryqëzonin pulëbardhat në perëndim.

Gjatë shtatorit, që kishte qenë edhe muaji i aksionit, ndërkohë që me klasën bridhja kodrave te qytetit, e kisha

mendjen krejt të shpërndarë nga dashuria. Kish qenë vërtet e vështirë për mua ta përbalja ikjen e saj larg. Në aksion, duke mbledhur misër, apo duke marshuar nëpër kodrat e Arapajt, nuk kisha bërë asgjë tjetër veçse kisha menduar, krejtësisht i pushtuar, orët e lumtura që kisha kaluar në plazh pranë Entelës. Kisha kujtuar ato orë plot dritë, plot lumturi dhe buzëqeshje vajzash të bukura. Kish qenë vërtet kohë e artë, kur luanim me top, me letra, llafoseshim me orë të tëra me këmbët e fundosura në rërën e qullët. Për mua, të dashurohesha kish qenë diçka krejt e natyrshme, e pashmangshme. Gjoksi i madh i Entelës, gjithmonë më kishte ndjellë neps. Tek e shihja ashtu, kisha pasur aq shumë dëshirë ta përkëdhelja. Por, po aq sa e dëshiroja një gjë të tillë, po aq edhe më dukej e pamundur, nëse ajo nuk bënte përpara me të njëjtën dëshirë reciproke. Për një vajzë aq të bukur, djemtë kapeshin edhe me grushte. E dija. Në plazh e ngacmonin nga të gjitha anët.

Atëkohë, me kalimin e muajve, kur vinte mbrëmja, nuk ia mbathja rishtas në plazh, i vetëm. Nuk bridhja më si i humbur bregut të detit në muzg, duke parë në heshtje kabinat e drunjta dhe të braktisura. Vargonjtë e pashpirt të dashurisë, sikur ma kishin çliruar pjesërisht shpirtin. Javët kalonin dhe Entela kishte filluar të mos vinte më çdo fundjavë me trenin nga Shkodra, pasagjerët e të cilit kalonin gjithmonë poshtë shtëpisë ku banoja unë. Pak nga pak po rivendosja rregull në trurin tim të shpërndarë. Nuk e prisja më të shtunave me ankth te dera e stacionit të trenit, duke ndier në shpirt muzikën vetmitare të vjeshtës pa të. Por edhe kur vinte, ishte gati e pamundur ta takoja, sepse

dilte gjithmonë i vëllai i saj, Neni, ta priste te stacioni. Ndaj veç i buzëqeshnim njëri-tjetrit në ecje.

Në shkollë ishim një klasë e mirë dhe kompakte. Ne do të ishim matura e dytë që do të përgatiste artistët e ardhshëm në qytet. Degë e cila ishte hapur një vit më parë dhe ku ne, durrsakët më të talentuar, dhe jo vetëm ne, përgatiteshim. Dëshira ime e zjarrtë kishte qenë të vazhdoja për pikturë dhe jo për skulpturë, por kish ngjarë diçka. Pas konkursit, të cilit iu nënshtrua duke vizatuar Lulen e Allçirit, piktori më i njohur i Shijakut, i cili ishte edhe kryetar komisionit, kishte kapur veçmas babanë tim dhe i kishte thënë: “Djali është paraqitur dobët. E dërguam për skulpturë, se përndryshe do të mbetej jashtë!” Nuk e di pse, por më ishte krijuar përshtypja se skulptura konsiderohej si lëndë e dorës së dytë, ku shumica ishin konviktore nga veriu dhe djem që vinin me abone nga rrethet.

Një pasdite fundvjeshte i vetëm po nxitoja të hapja derën e klasës së madhe të skulpturës. Prisja me ngut të vazhdoja punën me relievin grek, për ta paraqitur me krenari në ekspozitën e shkollës që bëhej në fund të nëntorit. Hapa derën, që kërkëlliti me një zhurmë të lehtë, sikur të lutej për diçka dhe era e fortë e baltës, e përzier me atë të pluhurit të padukshëm, i cili gjendej gjithkund, m’i mbyti hundët. Më thellë, në fund të sallës, vinte një si erë myku, si beze të palara edhe pse ne, shtatë nxënësit e klasës, nën mbikëqyrjen e rreptë të profesor Iliazit, e fshinim dhe e lanim dyshemenë me radhë sipas grafikut. Ndeza dritën dhe, për habinë time më të madhe, pashë se relievi, puna ime për të cilën isha lodhur me orë të tëra, kishte rënë nga kavaleti. Krejt

i habitur, me zemrën që filloi të më rrihte nga tmerri dhe mosbesimi, iu afrova. Nuk po kuptoja asgjë. Por s'po shihja aspak ëndërr. Si ishte e mundur? Unë e kisha lidhur aq mirë dërrasën, duke e shtrënguar me fije teli pas kavaletit. Pas një vëzhgimi të kujdesshëm, vërtetova me habinë më të madhe, se puna ishte dëmtuar me qëllim nga ndonjë keqdashës. “O ç'më gjeti!”, thashë dhe u ula në stolin aty afër, duke mbuluar fytyrën me pëllëmbë. Nga dëshpërimi isha gati për të qarë. Kush do ta kishte bërë, vallë? Çelësin e klasës e kisha vetëm unë?! Si ishte e mundur? I hidhëruar pa masë, ngrita pak kokën dhe e vështrova më me kujdes. Filluan të më rridhnin lot dëshpërimi. “Një muaj punë!”, mendova. Ma kishin dëmtuar. Orë dhe orë të tëra lodhjeje! Kush mund ta kishte bërë, vallë?! U kujtova se një kopje tjetër të çelësit e kishte profesori ynë. Po ai nuk kishte lidhje fare. U ngrita krejt i mpirë. Isha si në ëndërr, sepse akoma nuk doja ta besoja. Shikoja tani relievin e shkallmuar, me baltën e butë të dëmtuar nga grushtet dhe shkelmat e vulosur mbi të dhe mbeta gojëhapur. Gjurmët e këpucëve kishin ngelur ende mbi baltë si vula të turpshme krimi. Relievi, një metër katror, ishte dëmtuar gati tërësisht. Sillesha nëpër dhomën e punës duke fshirë lotët me mëngën e trikos i zhytur në mendime. Herë pas here më vinte në hundë një erë e rëndë banje, me siguri nga fuçia ku ne mbanim baltën rezervë. Hapa dritaren, pastaj iu afrova fuçisë në fund të sallës dhe ngrita kokën si rastësisht. “Shiko shiko!”, mendova. “Keqbërësi na paska hyrë nga kjo dritarja e vogël mbi dy metra lart!” Sipër fuçisë, në fund të dhomës së madhe të skulpturës, kishte një dritare të vogël, e cila lidhej me korridorin e errët dhe qorr

ku gjendej biblioteka e mësuese Tokut. Toku ishte mësuesja jonë e letërsisë. “Sabotim! Sabotim!”, fillova të thosha me zë të lartë. “Po përse? Përse? Kujt i kam bërë keq?”

Nini, shoku im nga Rrësheni, më gjeti me lot ndër sy. Nuk pati arsye të pyeste përse, sepse dëmtimi i pandreqshëm dukej qartë.

- Si ka mundësi?! - më pyeti, krejt i habitur edhe ai.

- Nuk e di! - i thashë i hidhëruar. - Sot paradite e mbylla vetë klasën dhe çelësin veç meje nuk e ka asnjë tjetër. U ktheva në shtëpi, hëngra drekë dhe në orën dy e gjysmë erdha sërish. Ja e gjeta kështu! - Pastaj, me lotët që më rrodhën përsëri, shkova drejt fuçisë së baltës dhe i tregova dritaren e vogël si qeli burgu, e cila i kishte menteshat e shkallmuara.

- Ja! - i thashë. - Që aty ka hyrë. Me siguri e ka bërë ndonjëri që më ka inat!

Nini ishte një nga shokët më të mirë në grup. Në përgjithësi, me konviktorët kisha një raport shumë të mirë. Ne të grupit të skulpturës ishim të tërë djem dhe kjo na jepte mundësinë të shpreheshim si shprehen çunat. Pa e çarë shumë kokën. Marini, djali nga Kukësi, na shkrinte fare me shakatë e tij prej malësori të mprehtë. Kurse Mandi, djali tjetër nga Rubiku, ishte gjithmonë si përgjumësh. Mandi dashurohej shpesh, por nuk e tregonte kurrë arsyen e vërtetë të përgjumjes së tij në konvikt. Ndërsa Lirimi dhe Jari vinin përditë nga larg, kishin abone, ndaj pasditeve nuk ishin asnjëherë të pranishëm aty. Kurse delja e zezë e grupit tonë të skulpturës ishte Veshtullor Mavrilla. Kishim një ndjenjë të çuditshme për Veshtullor Mavrillën. Ishte botë më vete,

rrinte përherë mënjanë, i veçuar, i pasigurt, me kokën e tij të madhe, trupin e gjatë dhe vetullat e trasha. Nuk fliste shumë. Nuk përzihej, nuk shprehej as nuk merrte pjesë në shakatë tona. Më shumë se prej nesh, ai dëshironte vetë të ishte “ndryshe”, të mos i afrohej dhe ngjitej grupit tonë.

- Kush mund të ketë qenë vallë autori?!

- Nuk e di. Nuk di që të kem armiq.

Nini më pa drejt e në sy. Deshi të më thoshte diçka, por pastaj u pendua dhe nuk foli. Mblodhi buzët nga mërzia dhe i nguli sytë për tokë. Pak më tej ishte rezistenca që e ndiznim kur bënte ftohtë. Ai u kujtua, u ngrit dhe e nderoi. Dhoma ishte përherë e ftohtë dhe e lagësht. Sidomos tani, pas asaj që më kishte ndodhur, dukej edhe më e ftohtë. Ishte e njëjta rezistencë me telin spiral, të cilin muaj më parë një nga shokët tanë e kishte lagur me ujin e hollë si për ta sfiduar të dridhurën e korrentit. Ia kishim plasur gazit me të madhe. Ç’mund të pritej nga fëmijë të pandreqshëm si ne - akoma me mendjen të shakatë.

- Me siguri e ka bërë ndonjëri që të ka inat.

Nuk foli. Rrija ende ulur dhe i dëshpëruar. Pastaj u kujtova se i kisha sjellë cigare Ninit. Gati të gjithë konviktorët pinin cigare. Babai im punonte te fabrika e cigareve, kështu që vjedhurazi, pa i thënë asgjë atij, i merrja grushte cigaresh të shkoqura dhe ua falja shokëve. Nxora cigaret nga xhepi dhe ia dhashë. Nini më falënderoi dhe nuk iu durua sa ta ndizte një. - E do edhe ti?!

- Bjere ta djeg edhe unë një! - i thashë. E nderova me mendimin të mos e kaloja tymin në mushkëri. E pija kot, sa për shoqëri, por nuk më tërhiqte. Nini ishte i bëshëm,

me flokët e butë dhe të drejtë, me hundën kockore edhe me lëvizjet e prera. Ishte djalë shumë i mirë dhe i dashur. Nga ata që nuk të linin kurrë në baltë kur kishe nevojë. Konviktorët si ai bënin dy herë në ditë nga 30 minuta rrugën nga shkolla deri te konvikti ku flinin, që gjendej në skajin tjetër të qytetit, përtej stadiumit. Ndërkohë që shkolla ishte afër portit detar.

- Kush mund të jetë ai maskara?! - po thoshte Nini duke thithur fort cigaren, sikur donte ta përpinte me gjithë filtër. Nuk e kisha kuptuar kurrë këtë dëshirën e zjarrtë të konviktorëve për t’u helmuar me nikotinë. “Mërzia!”, më thoshin. “Larg familjes!” Tani rrinte aty pranë dhe vazhdonte të shihte nga dritarja e vogël e shkallmuar.

- Tani si t’ia bëj?!

- Do të shkosh në drejtori të ankohesh?!

E pashë me mosbesim, duke thithur cigaren.

- Apo s’na kupton shumë mirë drejtori ne?! Ai kushedi ku e ka mendjen!

Xhon Gunga ishte një mesoburrë, shtatshkurtër, me sytë tinëzarë, të cilët vështronin gjithmonë vjedhurazi nëpër korridor, sidomos pasditeve. Rrinte gjithmonë si i bukri shejtan, duke u vërvitur nëpër korridore, sikur priste dikë në heshtjen e orës tre të pasdites. Më shumë se drejtor autoritar, dukej si bandit i gatshëm të thurte ndonjë paudhësi. Nuk e kuptuam kurrë, por gjithmonë diçka kërkonte tek endej fillikat, duke parë mësueset e muzikës nga dritaret e vogla të xhamit të dyerve, ndriçuar nga brenda. Me siguri bënte sondazhe surprizë, për t’u bindur nëse mësueset e muzikës punonin mirë dhe me

ndërgjegje socialiste. Na shihte gjithmonë me dyshim dhe na përshëndeste me një ngërdheshje false. Flitej se pushteti i tij ishte i padiskutueshëm. Miqtë e tij në Komitetin Qendror të Partisë, e bënë atë jo vetëm të paprekshëm, por edhe të plotfuqishëm. Ishte aq i pushtetshëm në shkollë, sa të gjithë i ruheshin dhe kishin frikë. Po të ta vinte syrin Xhon Gunga, mbaronte keq puna. Gjithmonë e gjenin arsye për akuzë dhe dënim.

- Ndoshta ai mund ta zgjidhë! Mund t'i shtrëngoje nxënësit të tregojnë të vërtetën kush ta ka dëmtuar punën.

- Nuk do të shkoj asgjëkund për t'u ankuar, - i thashë. - Dhe të lutem, ky muhabet, tani për tani, nuk dua që të dalë nga kjo dhomë!

Dhoma jonë e skulpturës, me dritaret me hekura, ndërtuar mbi tarracën e madhe të palestrës, gjendej në katin e dytë. Nga të tria dritaret e gjera, të cilat shikonin në drejtim të oborrit të madh të shkollës, futej një dritë e ftohtë veriu, por që mjaftonte për punën tonë, edhe pse ne brenda ndiznim gjithmonë dritat. Poshtë në oborr, kur kishim orë pushimi, luanim futboll me grupe. Ose rrinim duke u ngrohur në diell, ose duke kopjuar shpejt e shpejt detyrat e matematikës, apo ato të fizikës me Jolandën. Përreth dhomës kishte kavalete me punët tona shkollore të skulpturës dhe stola të gjatë ku vendosnim kompensatat me letrën sipër për të vizatuar modelet.

Nuk dija ç'të bëja. Rrija në heshtje dhe gjithë ai entuziazëm që pata atë ditë, gjithë ai hov, ajo ecje e nxituar për t'iu futur një orë e më parë punës me zell, duke punuar për të mbyllur relievin e madh, tani ishte shndërruar në pezm dhe mërzi.

Brenda, dhoma jonë kishte mure të bardha dhe të zhveshura, nga ku dalloheshin disa skulptura, imitime greke në allçi, disa relievë po grekë, syri i Davidit, dora dhe këmba e tij. Gjendej një kafkë e vërtetë dhe një bust në allçi me këmbët dhe duart e cinguar, ku tregoheshin muskujt e trupit. Përreth hapësira ishte e mbushur me kavaletat tona, mbi të cilat kishim vendosur skulpturat e baltës në proces. Ndërsa në mes, mbi një podium, rrinte heshtur karrigia ku ulej modeli. Ajo klasë ishte e gjithë bota jonë e atëhershme. Pak nga pak, ditë pas dite, ai vend na ishte bërë shumë i dashur. Ishte bërë sidomos për mua më i shtrenjtë se shtëpia vetë. Sepse, nëse shtëpia ishte vendi ku fati na e kishte caktuar të jetonim, atë vend unë e kisha zgjedhur vetë. Aty rrinim me orë të tëra duke vizatuar, aty diskutonim, aty qanim hallet, po aty bënim shaka, aty ziheshim dhe po aty dëgjonim me kujdes mësuesit kur na jepnin këshilla arti. Ajo dhomë bartte në hapësirën e saj ëndrrat tona rinore dhe unë isha nga të paktët që rrija më gjatë se të tjerët. Me mësuesit e pikturës kishim një raport të afërt dhe miqësor. Nuk ishte thjesht ai raporti akademik mësues-nxënës si në gjimnaz. Ata na trajtonin më shumë si kolegë të ardhshëm, si artistët e së ardhmes dhe, sidomos pasditeve, kur diskutonim, na zgjeronin njohuritë tona mbi artet e bukura.

Vazhdoja të rrija gojëvulosur. Në duar mbaja një copë baltë të butë dhe e shtypja me nervozizëm aq shumë, duke i ndryshuar me padurim formën, sa gishtat më ishin rrudhur nga lagështira e baltës. Shikoja punën e dëmtuar dhe rrudhja buzët duke shtrënguar dhëmbët. “Kush mund të kishte qenë ai qen bir qeni!”, mendoja plot hidhërim.

Ishte një relief grek me dy figura në ecje. Njëra - vajza elegante e veshur me një pëlhurë mëndafshi - i binte dajres në ecje, ndërsa prapa vinte një djalë tjetër me fizik atleti që mbante në krah një lëkurë luani dhe i binte fyellit. Duke e parë relievin nga modeli në allçi e kisha riprodhuar me kujdes në baltë, punë e cila më kishte marrë një kohë shumë të gjatë, por që unë e kisha qëndisur me endje dhe dashuri. E kisha këtë veti. Kur më rrëmbente pasioni për diçka, hidhesha kokë e këmbë mbi të, duke harruar gjithçka përreth.

Ndërsa si punë shkollore, të gjithë si grup ishim duke punuar në skulpturë duart e xha Sures. Xha Surja ishte një i moshuar nga Durrësi, i cili pozonte për ne. Ishte një plak i këndshëm dhe simpatik. Shpesh, kur profesor Iliazi dilte jashtë, i afroheshim xha Sures dhe fillonim e ngacmonim. Ai i mirëpriste shakatë tona. “Xha Sure!”, i thoshte Marini më zë të ulët te veshi. “Kur ke qenë i ri, a ke bërë ndonjë marrëzi me vajzat?!” Xha Surja, e merrte gjithmonë muhabetin seriozisht. Me seriozitet pozonte duke mbajtur pa lëvizur duart për 40 minuta, derisa i mpiheshin krejt dhe nuk i ndiente më. Por edhe më me seriozitet dhe përpikëri respektonte oraret dhe datat kur i duhej të paraqitej në shkollë për të pozuar. Edhe atëkohë, po aq seriozisht dhe me vëmendje dëgjonte shejtanllëqet që Marini ia pëshpëriste në vesh. Me një ndjenjë të fshehtë gëzimi prej adoleshenti, shihja Marinin tek komunikonte kokë më kokë me plakun Sure, i buzëqeshte me djallëzi dhe pastaj plaku ia këpuste një të qeshure të fortë prej të moshuari të lezetshëm. Ishte tepër i komunikueshëm. “I tmerrshëm kam qenë!”, ia kthente me sytë plot dritë, duke parë Marinin.

“Ne o xha Sure, s’po bëjmë gjë! U lodhëm duke gjuajtur, por s’po na e varin fare!”, i thoshte shpesh Marini me shaka.

“Mos u mërzit. Çdo gjë ka kohën e vet!”

“Aha, xha Sure! Më duket se koha jonë s’do të vijë kurrë! - ia kthente ai. - S’po na e varin fare!”

“Çfarë të ta varin ty. Shiko sa je, sa i vogël dhe i imët!”, nuk i durohej Jarit sa ta ngacmonte.

“Rri more ti, rri! Ku merr vesh ti. Një pëllëmbë përmbi tokë. S’të marrin as parà në autobus, sepse dukesh akoma si fëmijë!”

Jari shpesh skuqej nga turpi dhe sedra, por e dinte që Marini nuk ia kishte me të keq. “Ju konviktorët e ndritët fare, ju!”

“Ne? Ne nuk qahemi, Jar. Ne kemi vajzat e konviktit të fizkulturës. Ato po janë për ne. I kemi aty. Në të njëjtën godinë. Ta dish ti, mor çun. Ne u rregullojmë vajza edhe durrsakëve.”

Pastaj Marini i afrohej prapë xha Sures me djallëzi dhe seç i thoshte në vesh. Plaku skuqej krejt dhe ia niste së qeshurës nga e para.

“Si e ke emrin, or shejtan?! - e pyeste pastaj plaku Sure. - Ta harroj përherë.”

“Kush unë?!”, ia bënte Marini.

“Po ti!”

“Tarras!”

“Dëgjo, Tarras. Leje xhajën rehat. Jam këtu për punë. Nuk jam për gallatë!” Pastaj plaku kthehej nga të tjerët dhe i pyeste të gjithë me radhë për emrat. “Po ai atje që rri gjithmonë mënjanë. Ai syleshkoja i gjatë, si e ka emrin?!”

Marini (ishte qafëshkurtër dhe ne e vinim në lojë shpesh për këtë arsye), i afrohej dhe i thoshte emrin me zë të ulët te veshi. “Veshtullor Murrilla!”

Plaku përsëriste emrin duke u shkrirë gazit. Veshtullori, i cili ishte më tutje, bënte sikur nuk dëgjonte. Lëpinte me gishtat e zbutur nga balta format e skulpturës që po modelonte. Më pas shtrëngonte dhëmbët dhe lëvizte kokën anash në shenjë mosbesimi. “Veshtullor Mavrrilla!”, ia përsëriste emrin xha Surja. Këtë herë me një theks më bindës dhe më i vendosur se kurrë, sidomos kur i shoqëronte fjalët me lëvizjen e prerë të dorës përpara dhe me intonacionin e fjalëve. “Ve. Ve. Veshtullor Mavrrilla!”, ne të gjithë ia plasnim së qeshurës pa fund.

“Jo kështu! Por Murrilla!” Xha Surja e përsëriste, por nuk arrinte kurrë ta thoshte si duhej.

Xha Surja vuante nga zemra. Këtë fatkeqësi ne e dinim shumë mirë, ndaj kishim shumë kujdes me të. Sapo e shihnim që bënte lëvizje të çuditshme, të pakontrolluara, shpejt Marini i merrte trinitrinën që plaku e mbante në xhep të xhaketës, dhe ia vinim pa humbur kohë poshtë gjuhës.

Ndërsa ajo pasdite ishte aq e pabesueshme për mua. Një pasdite për t’u fshirë nga kujtesa. Sa më shumë kalonte koha, aq më e rëndë dhe e padurueshme bëhej. Iu afrova prapë punës së dëmtuar dhe, me ndihmën e Ninit, e ngrita relievin e rëndë. Tek e mbikëqyrja në heshtje, më dridheshin duart nga inati dhe më kot kërkoja ta riparoja, duke punuar mbi baltën e dhunuar plot mllef. Ishte dëmtuar aq keq, sa çdo orvatje për ta ndrequr ishte fare e kotë. Dukeshin ende gjurmët plot egërsi, lënë nga thonjtë, nga shenjat e

këpucëve që kishin goditur figurat. Përthyerja deri në krisje e telajos, mbi të cilën kisha ngjeshur baltën e relievit, ishte dhunuar si mos më keq, gjë që tregonte qartë inatin e hakmarrësit. Fytyrat e pafajshme të të dyja nudove lirike e kishin humbur shprehjen e tyre fillestare. “Po unë nuk kam armiq!”, mendoja me vete plot çudi. Nuk dija si të sillesha në të ardhmen. Kë të akuzoja? Pastaj a do t’ia dilja të merrja pjesë në ekspozitën e nëntorit? Ekspozitë, e cila bëhej me rastin e mbylljes së semestrit të parë? Isha krejt i turbulluar. Dhe ashtu, si të humbur, më gjetën edhe konviktorët e tjerë, të cilët erdhën pak më pas. Rrinin të gjithë në heshtje, sikur në dhomë të kishin vrarë dikë dhe asgjë nuk pipëtinte.

Në shkollë, edhe pse interesi më i madh dhe përqendrimi kryesor ishte për lëndët e pikturës, vizatimit, perspektivës dhe historisë së artit, kishim edhe lëndë të tjera. Por një nga lëndët që na thoshin se do të na shërbente në jetën tonë prej artistësh, ishte letërsia. Lëndën e jepte mësuese Toku, e cila ishte edhe mësuesja jonë kujdestare. E shkurtër, me një fizik prej atleteje, me fytyrën kockore dhe me lëvizjet e prera, mësuese Toku ishte një nga personalitetet më të rrepta dhe me autoritet në shkollë. Në marrëdhëniet me nxënësit ishte kërkuese dhe serioze. Shpesh na kërkonte llogari me vështrimin e saj të sertë, që nuk lejonte shkarje në orën e saj. Ndryshe nga mësuesit e tjerë disi më tolerantë, ku nxënësit shkriheshin së qeshuri nga batutat dhe ishin disi më të lirë, te kabineti i zysh Tokut nuk pipëtinte as miza. Në ajër ndihej frika e kërkesës së llogarisë që fluturonte gjithkund në klasë mbi shpirtrat tanë prej adoleshentësh. Atë mëngjes vjeshtë, heshtja në orën e saj ndihej dyfish. Kjo i shtohej autoritetit të padiskutueshëm të mësueses kujdestare, hija e rëndë e së cilës kishte raste që më bënte të dridhesha aty ku isha ulur. Në bankën e tretë djathtas, në rreshtin e mesit, që prej tre muajsh mungonte, tashmë përjetësisht një nga shokët tanë më të mirë. Një sëmundje e keqe në stomak e kishte sulmuar pabesisht atë verë. Iliri nga Rubiku ishte kthyer

atë shtator fare i verdhë dhe i dobësuar. Ishte përhapur fjala se Iliri kishte sëmundje të keqe. Tek e shihnim ashtu kockë e lëkurë, me drojë dhe me një tmerr të fshehtë, nuk dinim ç'të thoshim nga keqardhja. Por, në të njëjtën kohë, mundoheshim të mos i binim në sy. Nuk zgjati as një javë dhe të gjorin djalë, falë edhe ndërhyrjes dhe interesimit të mësuese Tokut, e dërguan përsëri me urgjencë në spital, ku e vizituan me kujdes. Pastaj mjeku e kapi veçmas Tokun dhe ia tha: “Ky djalë nuk shpëton. Ka sëmundje të keqe!”. Këtë herë nuk u kthye më. Ilir Vani na la në lulen e rinisë dhe, me ikjen e parakohshme, la në klasën tonë jo vetëm një dhimbje dhe zbrazëti të paimagjinueshme, por edhe një hije tmerrri dhe frike. Iliri nga Rubiku. Në vendin ku ulej, qëndronte gjithmonë një buqetë me lule të freskëta.

Si përherë, edhe atë mëngjes në klasë nuk pipëtinte asgjë. Zakonisht ankthi i orës së letërsisë vazhdonte gjatë gjithë pjesës së parë të mësimit. Sidomos arrinte kulmin kur mësuesja rrëshqiste stilolapsin fatal mbi regjistër dhe ngrinte në tabelë të pafatët, por që edhe nuk studionin sa duhej. Ndërsa në pjesën e dytë të lëndës, kur ajo e mbyllte regjistrin dhe shpjegonte, atëherë filloja të merrja frymë lirisht. Çliroheshja në çast nga një ankth i çuditshëm, më kthehej buzëqeshja. Hija e rëndë e asaj gruaje shpesh nursëze, kishte gati një rrëzëllim të padepërtueshëm. “Nga je moj zyshe?”, ia kthenim ne me njëri-tjetrin. “Nga Vlorra jam!” dhe lëvizim kokën siç bënte edhe ajo vetë. “Ah, tani e kuptova unë përrsenë e autoritetit tënd. Jeni nga Vlora! Nga vendi ku e bëjnë gjoksin gropë!”

Shpesh, kisha ndjesinë se merresha në pyetje në hetuesi, aq shumë rreptësi çlironte tek rrinte në këmbë dhe priste përgjigjen e pyetjes që më kishte bërë.

Veç vite më vonë, do ta kuptonim se ai lloj autoriteti, ku letërsia duhej të mbretëronte, do të na shërbente në jetë. Sidomos, nëse vërtet do të dëshironim të bëheshim artistë. “Mos kujtoni se do të bëheni artistë ashtu! - përsëriste shpesh. - Firifiu. Pa mend në kokë! Nëse doni të bëheni artistë, duhet të lexoni. Kultura letrare do t’ju ndihmojë dhe pasurojë fantazinë!” Dhe kur shqiptonte fjalën “firifiu”, e shoqëronte të folurën me lëvizjen e kokës dhe dorën e djathtë e ngrinte në ajër. Sikur me atë fjalë me bashkëtingëllore fëshfëritëse, të donte të ilustronte më mirë mendimet e kota, të cilat të lehta dhe boshe do t’i merrte era më lehtë.

Një ditë vjeshte, pasi hyri dhe hapi regjistrin, Toku mbeti pak mendueshëm, me sytë nga dritarja, serioze, e ulur si gjithmonë në katedër. Ndoshta për një çast po mendonte fatin e zi të shokut tonë, i cili ishte larguar nga jeta aq i ri. Pastaj dëgjuam një kërcitje dërrasash dhe menteshash dhe e pamë të ngrihej me një libër në dorë. Nga xhamnaja e madhe e dritareve, që shihnin nga perëndimi, drita e ftohtë futej edhe më me vrull, sikur të donte të ishte edhe ajo vetë dëshmitare në orën e letërsisë. “Sot do të flasim, - ia pat në çast, - për jehonën ndërkombëtare, për suksesin që po korr në botë një nga librat më të rëndësishëm të shkrimtarit tonë Ismail Kadare: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur!”” Për një çast, ndaloi së foluri. Preku me gishtërinj flokët e zinj, të prerë shkurt prapa qafës dhe, me trupin e lidhur, eci me hap energjik drejt katedrës. U ul, vuri syzet dhe mori gazetën “Drita” në dorë. “Gjenerali”, - shtoi pa humbur kohë, - është një vepër novatore në letërsinë shqipe...”

Rrija në bankë me Vanën nga Kavaja. Ishte një histori më vete zgjedhja e shokut të bankës në shkollë. Atë e vendoste Toku, duke pasur parasysh natyrat tona, formimin dhe mbarëvajtjen tonë në mësim. Po të ishte për ne djemtë, të gjithë do të donim të kishim në krah më të bukurën e klasës, Janën. Kaçurrelësen me sytë blu dhe buzët si luleshtrydhe. Por, po të na binte radha të kishim në krah edhe një nga nxënëset shembullore, prapë mirë do të ishte. Sepse gjatë orëve të provimit, do të përfitonim prej tyre duke kopjuar.

Dy vajza kishte shkolla e pikturës, të cilat spikasin për paraqitjen e jashtme. Jana në klasën tonë dhe Alma e klasës sipër nesh. Alma ishte ulërimë fare. Gjoksi i saj e bënte ta ëndërronin të gjithë djemtë e arteve figurative. Deri dhe bukuroshin Elio Shaplaku, për të cilin vajzat linin kokën. Kur Alma kalonte nëpër korridore, ai i jepte një të lëvizur energjike kokës, duke risistemuar baluket e dendura mbi sytë blu.

Atë ditë po rrinim të gjithë në heshtje. Ora kishte filluar ndryshe, ndaj ndihesha i çliruar nga ankthi i ngritjes në tabelën e zezë. Kishte momente kur mbretëronte veç zëri i mprehtë dhe i hollë i mësueses kujdestare.

Në përgjithësi, kur djemtë më të lëvizshëm të klasës, si Pashku, Endi apo Blend shiakasi, fillonin të flisnin me zë të ulët nga bankat e fundit, atëherë mjaftonte një vështrim prej shqiponje i Tokut dhe heshtja e rëndë mbizotëronte rishtas në klasë. “Me ‘Gjeneralin’, Kadarë na ka dhënë idenë e madhe të kotësisë së luftës dhe të shkatërrimit të trishtueshëm që ajo la më pas në jetën shoqërore shqiptare. Armiqtë tanë...”

Rrija me vështrimin e ngulur te buzët e thata të mësueses kujdestare dhe ndiqja lëvizjet e nofullave të saj. Vështroja nofullat pak mashkullore dhe nishanin e zi, por mendja më fluturonte te puna e dëmtuar. Kush kish qenë keqbërësi, vallë? Për një çast, humba në mjegullën e mendimeve. M'u shfaqën fragmente jete. Hija e çadrës në plazh, dielli që ngrohte egërsisht lëkurën time të nxirë. Buzëqeshja e mrekullueshme e Entelës. Zhytjet në ujën e ngrohtë pasditeve. Aty për aty më erdhi ndër mend të pyesja Krenarin. Krenari me siguri dinte diçka. Keqbërësi kishte hyrë nga dhoma ku ai ushtrohej me kontrabasin. Ndoshta kishte parë ndonjë lëvizje të dyshimtë?! Krenarin. Po Krenarin do të pyesja.

- Artur! - më tërhoqi vëmendjen mësuese Toku, së cilës nuk i shpëtonte asgjë! - Ku e ke mendjen mor djalë?!

E pashë si nëpër gjumë.

- Ku e ke mendjen po të them? Ç'më sheh ashtu si guhak?! - Të gjithë vunë buzët në gaz. E pashë të largët, sikur të vija me ngut nga një botë tjetër. Shkunda kokën dhe u mundova të përqendrohesha. Por Toku, e cila nuk ia përtonte me format e saj të prera, m'u afrua dhe me tonin e rreptë, duke picërruar sytë, m'u drejtua: - Ngrihu!

Unë u ngrita me lëvizje të ngathëta. Zysha kishte marrë një qëndrim si prej këndesi. - Për çfarë po flisja?! - më pyeti, duke afruar veshin e saj të djathtë nga unë. Rrinte në këmbë, anash bankës. Mbeta si i shastisur nga hutimi. Nuk dija ç'të thosha. - Për "Gjeneralin"?! - dëgjova nga mbrapa bankës pëshpërimën e ëmbël të Janës. Fytyra e saj ishte aq e freskët dhe e pastër, sa nuk ngopeshe së pari. I kishte buzët mishtore dhe me një cipë të hollë rozë ku vlonte jeta rinore.

Si për ironi të fatit, vajzën më të bukur të klasës, në orën e letërsisë e kisha prapa krahëve. Nuk e shihja dot, edhe pse ndieja aromën e freskisë së saj. I zënë në befasi, po rrija ende në heshtje dhe po shtrydhja trurin si t'i përgjigjesha mësueses. - Për "Gjeneralin"!

- Për ç'gjeneral? - vazhdoi ajo duke pyetur në heshtje, me një qëndrim autoritar.

- Për një iks gjeneral! - Klasa u gajas.

Qëndrova në heshtje dhe ula kokën krejt i skuqur.

- Këtë herë po ta fal! - vazhdoi ajo duke tundur kokën me ca lëvizje të prera. - Por ta dish, që herën tjetër do të të vë katër në regjistër! Ki mendjen në mësim. Tutkun!

U ula në heshtje. Jo pak nxënës e merrnin lëndën e saj shumë seriozisht. Por kishte djem si Endi apo Pashku, të cilët nuk ia përtonin dhe shpesh rebeloheshin, duke bërë edhe debate të gjata me mësuesen kujdestare. "Ti zyshe e ke inatin me mua! - iu ngritën nervat njëherë Endit. - Po. E ke inatin me mua. Gjithmonë më bie në qafë!" Nuk ishte e thjeshtë t'i ktheje fjalën mësueses më të rreptë të shkollës, nën "kamxhikun" e së cilës ishin bërë zap shumë lëkura nxënësish rebelë. "Në orën time unë dua vëmendje edhe seriozitet. E kuptove!", i ishte kthyer Endit në atë rast. Ishte problem i madh të të vinte në shënjestër mësuesja, por Endi nuk e vriste fort mendjen. "Si të duash o zyshe! Mirë. Unë jam këtu. Ky është pozicioni im si nxënës. Ndaj ti e ke vetë në dorë. Bëj si të duash! Pushtetin e ke ti."

Endi ishte trupbëshëm dhe energjik, ndaj kur ngrihej të debatonte, banka e vogël lëvizte bashkë me të. Dukej sikur edhe vetë dërrasat donin të ngrinin krye kundër pushtetit të padiskutueshëm të Tokut.

Atë ditë, pas orës së mësimit, sapo zilja e madhe e korridorit tringëlloi me ulërimën e saj çjerrëse, e gjithë klasa filloi të pëshpëriste fjalë padurimi. “Nuk kam mbaruar! - ngriti zërin mësuesja e letërsisë me një forcë të re. - Herën tjetër dua që ta keni gjetur ‘Gjeneralin’ dhe ta keni lexuar. Kuptuat? Pastaj do ta komentojmë të gjithë bashkë në klasë!” Sa më shumë nxënësit lëviznin me padurim për t’u çliruar nga zgjedha e 45 minutave, aq më fort ajo ngrinte zërin, sikur të donte me zërin e saj çjerrës t’u tregonte nxënësve se ishte ajo që komandonte në orën e letërsisë.

Me zhurmë dhe potere dolëm jashtë, duke biseduar grupe-grupe. Klasa u zbraz në çast dhe bankat mbetën të shkreta.

- Artur qëndro pak! - më tha mësuesja.

E pashë me habi.

- Të kanë dëmtuar punën ty?!

- Po!

- Po kjo s’do të thotë që të mos jesh i vëmendshëm në klasë! Nuk fola.

- Kush mendon se ka qenë?!

Ngrita supet.

- Po ju nga e dini?!

- Po si nuk e di. Kanë shkallmuar dritaren ku gjendet biblioteka. Unë aty rri një kohë të gjatë!

Nuk dija ç’të thosha.

- Mos u mërzit. Do ta nxjerrë kokën ai rrugaç. Herët a vonë! - më tha. - Dhe herë tjetër kije mendjen në mësim!

E përshëndeta dhe dola. Sapo u gjenda jashtë, korridori shumë i errët i katit të dytë po bllokohej nga trafiku i nxënësve, që tani po ndryshonin klasat. Një erë e mugët

ajri të ngjeshur dhe djerse ishte përhapur gjithkund. Grupe nxënësish zhurmëmëdhenj, tek nxitonin, bllokoni kalimin e grupeve të tjera. E jona, ishte e vetmja shkollë në qytet ku kishte edhe nxënës të tetëvjeçares. Arsyeja ishte se kush studionte muzikë dhe i binte veglave muzikore, duhej të fillonte ushtrimin me instrument që në moshë fare të njomë. Ushtrimi me veglat muzikore kërkonte vite punë, studim dhe lodhje.

Me kujdes, duke shmangur trafikun e nxënësve, duke hapur rrugën me duar, zbrita poshtë të arrija grupin tim. Gumëzhima e fëmijëve tani përzihej gjithkund me tingujt e pianos dhe të violinave. Orën tjetër e kishim pushim. Do të shijonim diellin e vjeshtës së bashku, ulur te bordura e gjatë e vendstrehimit kundërajror.

Ne djemtë uleshim gjithmonë bashkë, duke marrë rrezet e diellit të mesditës. Rrinim tok, duke diskutuar me njëri-tjetrin. Shokët e klasës po komentonin një film. Por shpejt ra heshtja.

- Tur! - më pyeti Liri. - Është e vërtetë që të kanë prishur punën?! - Kur pyeti, aty ishte i gjithë grupi i nxënësve. Zakonisht krijonim një rreth, me fytyrat kthyer nga njëri-tjetri. Mblodha buzët dhe ula kokën në heshtje. - Nga e morët vesh kaq shpejt, - turfullova tërë mllef duke ngrënë fjalët.

Liri ishte një nga djemtë më simpatikë të klasës. Ishte me trup të bëshëm, shpesh i hutuar dhe këpuste batuta pa të keq. Por ama, kishte një dell të rrallë në hedhjen e ngjyrave dhe në vizatim, sa habiteshin edhe vetë pedagogët. Gjithmonë i heshtur, rrinte shpesh mënjanë dhe dukej sikur jetonte krejt i zhytur në një botë të tijën. Kur e thërrisnim Lirin nga larg,

na shihte si me mosbesim, pastaj, krejt i habitur, drejtonte gishtin nga vetja dhe pyeste: “E ke me mua?!”.

“Me ty e kam o trap. Hajde pak!” Ai ia fuste me vrap. Të vraponte, Liri e kishte më të natyrshme sesa të ecte me hap. Shpesh, më krijohej përshtypja e marrë se nuk i kapte gjërat në çast, por, ama, kishte një dorë mjeshtri nëpër skica vërtet të shkëlqyer. Me fizikun e tij prej atleti, Liri i tregonte gjithmonë historitë duke lëvizur torsin. Me duart përpara dhe me pëllëmbët e hapura jepej i tëri pas tregimit.

Atë çast po rrinte përbri meje. Të gjithë po prisnin ç’do të thoshte. - Hej, e morët vesh? Turit, çunit të Iliazit, i kanë prishur punën! Shokët më kishin vënë nofkën “çuni i Iliazit”, sepse profesori i skulpturës, jo vetëm më mbante afër dhe më ftonte shpesh te studioja e tij, por e tepronte duke më lavdëruar para klasës në orën e Perspektivës.

- Vërtet?! O sa keq! Të tjerët menduan se po bënte shaka.

- Kujt po i rruhet?! - Ore, e dëgjove?

- Po, e mora vesh!

Ktheva kokën nga Nini. Ai ngriti supet.

- Vërtet?! - dëgjova një zë tjetër.

- Po! - pohova duke shtrembëruar turinjtë. Isha tërë mllef. Përreth dëgjoheshin tani pëshpërimat e habitës. - Çudi e madhe? Si ka mundësi? Po na vjen keq! Kush do të ketë qenë vallë? - Pastaj pasoi një heshtje e rëndë. Djemtë me fytyrat e çuditura filluan të mendoheshin. Pas pak i dëgjova të flisnin të ndarë në grupe të vogla.

Koha ishte e bukur. Dielli ndrinte fort dhe nuk bënte ftohtë. Përmes oborrit të shkollës shtruar me asfalt, kalonin nxënës të moshave të ndryshme, nga fëmijët e shkollës

fillore, të cilët nga mesdita fillonin t'u binin veglave muzikore nëpër sallat e vogla apo cepave të korridorit deri te më të rriturit. Ishin të bukur, sidomos vajzat, që si lulka erëmira, me gishtat e vegjël, me flokë si mëndafsh dhe me sytë plot dritë ushtroheshin përpara dritareve.

Gjithkund në oborr dëgjohej zhurma e gëzuar e fëmijëve, që nuk reshtte as për ndonjë pushim të vogël dhe që mbaronte në mesditë. Ndërsa pasdite heshtja prishej vetëm nga veglat muzikore. Korridoret kishin një gjallëri të veçantë. Një gjallëri moshe të njomë. Ato jetonin gjithmonë nën trysninë e tingujve të muzikës. Rrinin ashtu, si të dënuara nga vetë fati i tyre, me format e ftohta prej muresh të shurdhëta lyer me gëlqere. Korridoret, bashkë me dhomat e solfezhit, ngjasonin me skena teatroshe të zymtë a plot dritë, ku nxënësit dhe mësuesit luanin rolet e tyre. Përtej dritareve të xhamit, çdo dhomë e vogël kishte tingujt e vet. Melodi që luheshin pa ndërprerje. Përsëriteshin deri në lodhje, derisa nxënësi apo nxënësja të arrinte përsosmërinë në interpretimin e pjesës me instrument.

Rrija ende ulur mendueshëm te bordura e çimentos. Duhej patjetër të bisedoja veçmas me Krenarin. Krenari ishte violonçelisti, i cili studioje në dhomën e vogël me dritaren që shihte brenda klasës së skulpturës. Keqbërësi ishte futur prej andej. Dyshoja për një tip, për të cilin nuk kisha pasur asnjëherë simpati. Antipatia jonë kishte qenë e dyfishtë, reciproke qysh në fillimet e njohjes. Përpiqeshim ta shmangnim takimin me njëri-tjetrin. Më dukej se nuk kishte asnjë shteg miqësor që mund të më shpinte drejt tij. Shmangnim vështrimet, i rrinim larg njëri-tjetrit, derisa një

ditë ishim grindur me fjalë plot spica helmi dhe ironi. Pak nga pak kisha zbuluar se edhe disa nxënës të tjerë në klasë, nuk e kishin me sy të mirë dhe këtë ai e ndiente, ndaj kishte filluar të veçohej vetë. Tek ai dyshoja më shumë, por dyshimi, dihej, ishte veç dyshim, ndaj, nëse nuk e kapja tjetrin me presh në duar, nuk mund ta akuzoja kurrsesi. Përse vallë ta kishte bërë një gjë të tillë? Xhelozia e rëndomtë nxënësish ndoshta?! Inat adoleshentësh që aspironin të bëheshin artistë? Apo ndoshta ishte një dëshirë e marrë për të qenë vetë i pari në grup? Edhe pse ishim ende të vegjël, edhe ne kishim zilitë tona, ambiciet tona, inatet tona të fshehta. Shpesh, gjatë muajve të kaluar, profesori i skulpturës më kishte bërë lavde përpara gjithë klasës, duke më quajtur punëtor të madh. Lavde, të cilat më kishin detyruar të skuqesha krejt nga turpi dhe sedra. Aq shumë isha bërë me turp, sa i kisha thënë veças profesorit: “Të lutem mos më bëj lavde përpara klasës! Më vë në siklet!”. Ja tani rezultati i lavdeve! Dikush ishte bërë xheloz dhe ma kishte prishur punën. Orë të tëra impenjimi, mbasdite të tëra lodhjeje, tani kishin shkuar dëm. Me siguri ndonjë ndyrësirë e klasës i shtyrë nga inati ma kishte bërë të pabërën.

Po rrija ulur te bordura duke kafshuar buzët, ndërsa nëpër mend më kalonin gjithfarësoj mendimesh të kota. Liri ishte ulur në krahun tim dhe po lexonte një libër. Me një shqetësim të veçantë dhe plot nerva iu shkarkova Lirit.

- Ç'm'u desh edhe mua ta bëja atë relief aq të madh! Kot e bëra! Ja ç'ndodhi!

- Mos e thuaj atë?!

- Kot. Ja, ma punuan!

- Kot thua ti! - m'u përgjigj tjetri. - Ty të duket që veç ke humbur. Por në të vërtetë nuk ke humbur asgjë. Gjithmonë mësohet diçka e re kur merresh me skulpturë!

Djemtë rrinin grupe-grupe tek oborri i shkollës. Një pjesë bënëin batuta dhe shaka. Të tjerë luanin. Dikush lexonte apo kontrollonte detyrat e orës tjetër, kur kaloi profesori i ushtarakes, Zakja. Zakja ishte rob zoti. Tërësisht i kuq në fytyrë, ecte me flokët po të kuq flakë që i valëviteshin. Ecte gjithmonë me duart mbrapa dhe buzëqeshte duke folur me veten. Na trajtonte gjithmonë si shokë, jo si nxënës dhe dihej se kjo ishte aq gjë e bukur për ne, por nuk duhej aq sepse nga afërsia e tepërt nxënësit mund të përfitonin. “Ej, djema! U njohëm pak si shumë tani!” Këtë nuk e dëgjuam kurrë nga goja e Zakes, i cili dukej fare i ri si Balaj, o Makbethi. Ndoshta pesë a gjashtë vjet më i madh. Zakja pinte, por nuk arrije ta kuptoje kurrë nëse kishte pirë apo jo. Por, natyrisht, më të kuq nga ç’e kishte bërë natyra, pija nuk do të arrinte kurrsesi ta bënte më shumë. Nuk e humbte kurrë kontrollin e vetvetes dhe kishte një ëmbëlsi, një shpirt shoqëror dhe paqësor mbas dopiove të fërnetit shtohet edhe më. Kur e tepronte me fërnetin dhe bota i sillej vërdallë, tek ia këpuste batutave, na dukej se, nga çasti në çast, do të rrëzohej. “Ra, ra, ra mësuesi. Buzë e hundë!”, thoshim të trembur, por, kur mendonim se mund të binte, ai shpejt ndërronte pozicionin e këmbëve dhe mbahej. “Ulu, mor presor. Ta marrim shtruar!” Zakja picërronte sytë. “More ti. Kujt i bën pordha ti. A e di se si mbahet pushka, apo jo?!” Shkuleshim gazit. Pinin përherë me Lutin e fizkulturës dhe me Baken e anglishtes. Nga kjo mesele,

kur binte fjala për ta, qarkullonte në shkollë edhe shprehja, të cilën ne nxënësit e përsërisnim me zë të ulët, me sytë si lugetër: “Zake, Bake futi nga një teke. Zake Lut futi nga një m...” Bakja i anglishtes ishte trupvogël, energjik, i beftë dhe përçmues. Edhe pse fare xhuxh, ai ishte qenia më e gjallë dhe më energjike që kisha parë ndonjëherë. Mbi të gjitha Bakja zotëronte një zgjuarsia dhe mprehtësi prej anglezi të vërtetë. Edhe pse në pamje të parë të jepte përshtypjen e një komunisti të flaktë, Bakja kishte një mendësi dhe formim perëndimor. Sistemi, jam i bindur, na sugjeroi sjelljen e dyfishtë: nga njëra anë siç e donte Partia dhe, nga ana tjetër, siç mendonte vetë njerëzia me mend. Pra, që ai sistem ishte hipokrit vetëshkatërrues dukej fare qartë nga gjykimi i një njeriu me mend në kokë. Shpesh e shihja të ecte nëpër korridoret e errëta. Takat e këpucëve të tij kërcisnin mbi dysheme frikshëm dhe, kur afrohej, dukej sikur po vinte një stuhi. Nëse ne nxënësit do të gabonim dhe do t’i hidhnim sytë nga ai, edhe kjo mundësi ishte e madhe, sepse, duke zotëruar një magnetizëm të theksuar, ishte e pamundur të mos ia hidhje sytë, kur e ndeshnim në ecje, ai aq donte.

“Hajde këtu! - thoshte duke ngritur syzet e trasha dhe duke rrudhur vetullat. - Ç’bën që sillesh kot vërdallë?”, pyeste me këmbët e hapura dhe me duart e mbledhura prapa.

“Jo, profesor. Po iki në klasë!”

Por ai vazhdonte të kërkonte llogari. “Ç’bën ti more nëpër korridore? Nuk ke mësim ti, more spurdhjak?” E ngrinte zërin vazhdimisht, si karrukola e një radioje dore. Nga goja e tij dilte gjithmonë diçka e thënë gati me përçmim. Sa më shumë bëhej tapë, aq më shumë ishte i

pandreqshëm dhe kryeneç. Hapte edhe më shumë këmbët e shkurtra, si për ta ruajtur më mirë ekuilibrin e trupit të tij shkurtabiq, përveshite llërët sikur të donte të të zhdëpte në dru, mbështeste duart mbi vithe dhe, duke varur turinjte plot mllef e përçmim, i drejtohej nxënësit: “Pse sheh ashtu, more leshko? Kujt i ecën ti me gjithë atë tangërllek? Je nxënës ti, apo ç’je që bredh korridoreve në orë të mësimit?” Më kujtonte gjithmonë personazhin e filmit “Kapedani”, i cili urrente gratë. Kishte nga ata nxënës rebelë që ia kthenin fjalën pa një pa dy. Kur pinte, dhe bota i sillej vërdallë, bëhej më interesant. Bëmat me Baken në orën e anglishtes ishin nga më të bukurat për t’u rrëfyer. Veçse Bakja nuk e kishte pijen me hare si Zakja, por me mllef dhe me zënka. Ndaj nxirrte shpesh breshëri fjalësh plot inat dhe përçmim kur tentonin ta kundërshtonin: “Ule more zërin se nëpër salla jepet mësim!”, i thoshte nxënësve, edhe pse ishte ai që bërtiste më fort se ata vetë. Ndodhia më fatale ishte kur të piketonte që larg dhe vendoste të shfryhej me dikë. Arrinte të të fuste në rrezen e tij të vështrimit sfidues dhe të ta merrte frymën duke kërkuar llogari. “Ku do të shkojmë profesor?!” e kishte pyetur një nxënës, kur ai, i kishte urdhëruar të iknin nga klasa e tyre pa zhurmë, sepse profesoresha atë ditë mungonte. “Në të s’ëmës!”, kishte mërmëritur nëpër dhëmbë. Pastaj, me sytë e zgurdulluar nga pija, e kishte kapur prej shalli nxënësin dhe e shkundi me të gjithë fuqinë. Ishte e çuditshme dhe pak qesharake të shihje Baken, një metër të gjatë, tek bënte zap edhe nxënësin dy metrosh. E tundte dhe e shkundte duke i zgjatur duart që poshtë, sikur të kishte xhindet në trup. “Ku shkon

ti more me atë bluzë Boston! Hiqe shpejt! Ku jemi ne këtu? Qafir!”, dhe gati sa nuk ia shqyente bluzën me duart grusht mbërthyer mbi të.

Nuk ia kalonte njeri për dinakëri. Në grupin tonë të skulpturës shkolla na kishte sjellë si model një djalosh të ri rom. Një nga ata të portit, të cilët ishin edhe më të vjetër në qytet sesa durrsakët vetë. Pozonte si model te ne, që prej shumë javësh, por, duke pretenduar të paguhej javë për javë nga shkolla dhe jo në fund të punës, i pakënaqur, një ditë të bukur kishte sjellë vëllanë e madh ta zgjidhte këtë problem.

- Kam frikë se nuk do të m’i japin lekët. Hec një herë!

I vëllai, qymyr i zi, kishte ardhur me nxitim.

- Nuk ia kenë dhënë akoma lekët! - ngriti zërin i vëllai, duke iu hakërryer profesor Iliazit, më keq se tifozët e sëmure në stadium.

- Në fund do t’ia japim të gjitha bashkë, or shok! Ashtu e ka rregullin shkolla! - ia ktheu profesor Iliazi.

- Jo i dua tani! - ulërinte romi. - Përndryshe vëllai nuk vjen më!

- Ule more zërin, se le nam. Po na dëgjojnë të gjithë! Nuk jemi në pyll këtu. Jemi në shkollë.

- Jo, dua lekët. Do të shkoj të ankojem në drejtori, po nuk m’i dhe tani! - vazhdonte vëllai i madh, duke ngritur zërin.

Profesor Bakja, i cili qëlloi aty rastësisht, hapi derën e klasës dhe, kureshtar të merrte vesh ç’bëhej, hyri brenda. Profesor Iliazi po rrinte përballë atij që hakërruhej.

- Ç’është kjo gjullurdi? Tërë kjo shamatë? Si ulërima qensh! - ia pati Bakja. - Kush je ti? - e pyeti vëllanë e madh të modelit.

- Unë?! Ç'të duhet ty?! Ti kush je?

- Unë jam drejtori i shkollës.

- Unë jam vëllai i madh i këtij këtu! - tha dhe tregoi me gisht modelin, i cili nuk pranonte të zhvishej për të pozuar.

- Si është puna?! - ia ktheu Bakja duke ngritur zërin më keq.

- Im vëlla pozon këtu si model. Por këta nuk i japin lekët e punës! - ia ktheu romi i xhindosur dhe i revoltuar.

- Ti je vëllai i këtij?

- Po! - iu hakërrye romi gjithë krenari. - Ta thashë një herë!

- Pasaportën! - i tha Bakja me një qëndrim serioz dhe të rreptë. Trupvogël, por autoritar, profesor Bakja, dukej sikur atë që i mungonte në gjatësi e kompensonte me gjakftohtësinë e tij të padiskutueshme. Romi, i zënë ngushtë, i hutuar nisi të prekte me pëllëmbët plot nxitim xhepat, por nuk e gjente dokumentin. I zënë ngushtë, nuk dinte si të vepronte.

- Nuk e kam! - mërmëriti tjetri.

- Me vrap në shtëpi. Më sill dokumentin. Ku jemi ne këtu?! Bredh tjetri pa dokument! - Vëllai i modelit ia mbathi me vrap drejt shtëpisë. Tek prisnin pa fjalë, gjakrat kishin filluar të qetësoheshin. Ndërkohë, Bakja ishte kthyer nga Iliazi dhe i kishte shkelur syrin si për t'i thënë: "E di unë si e duan këta".

Unë bëja rusisht me kunadhen Poli. Kështu e quanim ne nxënësit nëndrejtoreshën për arsye të hundës që e kishte pak të zgjatur. Për fatin tim të keq, nuk bëja anglisht me Baken.

Shokët e klasës bënin be e rrufe se nuk do ta ndërronin kurrë me asnjë profesor tjetër Baken simpatik. “Është i mrekullueshëm! - shpreheshin entuziastë. - Na kënaq!”

Historitë me profesor Bakushin ishin pa fund në shkollë. Njeri kërkues, njohës i thellë i anglishtes, Bakushi ishte një nga ata mësues, i cili, njëlloj si Toku e letërsisë, kishte një karakter dominues dhe një autoritet të padiskutueshëm. Me flokët e lëpirë, për të fshehur tullacërinë, me shprehjen e tij në dukje arrogante, me sytë e vegjël prapa xhamave të errët prej miopi, ai i ngjante më tepër një aktori komik sesa një mësuesi të anglishtes. Lexonte e lexonte pa fund dhe, me kulturën e tij të gjerë, kishte bërë për vete gjithkënd që e njihnte nga afër. Sa më shumë kalonte koha, aq më shumë treshes së rakisë i rritej nami në shkollë. Por, nëse Bakushi ishte i përpiktë dhe kërkues, nëse Luti ishte në dukje i egër dhe me një dell humori krejt të veçantë, Zakja ishte më moskokëçarësi se gjithkush tjetër. Duke qenë se jepte lëndën ushtarake, e cila nuk e kishte pushtetin hijerëndë të matematikës apo fizikës, ai i afronte nxënësit edhe ngaqë tregonte barcaleta djemsh. Ishte falë këtyre qyfyreve që bënë në orët e Ushtarakes që Zakja arriti të zbulonte kush e bënte rakinë më të mirë në familjet e nxënësve. Ai që iu ofrua më shumë ishte Pashku nga Rrushkulli. “Eja profesor, eja! - i thoshte Pashku dhe i fuste krahun Zakes, mbasi mbaronte ora e ushtarakes. - Kam një raki të mirë. Safi rrush Rrushkulli” - i pëshpëriste në vesh. Pashku ishte i tmerrshëm për t’i bërë shokë pedagogët. Veç me Tokun nuk i ecte. Filluan të pinin bashkë te Klubi i Oficerëve.

Pashku, i gjatë dhe i hedhur, ishte nja dy vjet më i madh në moshë sesa ne. Ai filloi të bëhej tapë me raki rrushi me Zaken dhe miqësia e tyre po binte në sy në të gjithë shkollën.

“Ç’është kjo miqësi kështu?!”, i tërhiqte vëmendjen nëndrejtoresha, kunadhja Poli.

“Asgjë e keqe. Miq jemi”, ia kthente Zakja.

“Nuk të shkon që të miqësohesh kaq shumë me një nxënës!”

“O Poli! - e mbronte Bakja, i cili kishte me Polin një miqësi tridhjetëvjeçare, që nga koha e fakultetit të gjuhëve të huaja në Tiranë. - Lëre këtë muhabet. Ndonjë shishe raki i sjell. Asgjë më tepër!” E kështu e mbyllën.

Kjo ishte arsyeja pse Pashku, i cili ia kish varur fare shkollës, i kalonte pa djersë të ftohta lëndët më të vështira. Dhe disa, si ushtarakja apo fizikultura, i dolën dhjetë, edhe pse shpesh nuk paraqitej fare. Pashku bënte pallë gjithë vitin shkollor, pastaj, një muaj përpara se të mbyllej semestri i dytë, me shishe raki Rrushkulli, i zgjidhte problemet e mungesave dhe të notave pakaluese.

Zakja ishte hataja vetë. Profesor, të cilin ne e rrethonim siç rrethonin dishepujt e pamësuar mjeshtrin. Sidomos gjatë zborit. Kur vinte zbori, asnjë nga çunat nuk i ndahej Zakes, i cili donte të dinte cilat ishin ato vajza të shkollës sonë që e luanin bishtin.

“Kledjana nga Vora e klasës tjetër!” u turr njëri një ditë plot zell. Kledjana ishte me nam, por Zakes s’ia mbante. Të vetmit që i kish dalë nami që i ecte me vajzat ishte Flokteritali. Edhe zullapi i fizikulturës bënte ca lëvizje të dyshimta dhe shpesh e kishim pikasur tek fliste vetëm për vetëm me ndonjë vajzë të lëvizshme jashtë orëve të fizikulturës. Kur vajzat dilnin me kilota, e shihnim si i përpinte me sy vajzat. Gjahu më i sigurt ishin konviktoret, që ishin larg kontrollit familjar.

Ndërsa me mësuesit e pikturës shkonim shpesh nëpër ekskursione a në praktikë mësimore. Praktikantët ishin javët më të bukura në jetën tonë artistike e shkollore. Gjatë atyre udhëtimeve, qofshin në Tiranë, Dajt, Berat apo Gjirokastrë afroheshim më shumë me njëri-tjetrin. Sidomos gjatë ditëve të zborit çelëshim, argëtoheshim dhe krijohej kështu një afrimitet disi i veçantë. Në orët e mësimit, të ngurtësuar nga frika, nuk arrinim të flisnim lirshëm. Por, kur ngjiteshim mbi trena dhe autobusë, ishim të gjithë të shpenguar dhe pa mbikëqyrjen e rreptë të mësuesve. Ishin çastet kur vështrimet tona kërkonin sy, buzë, fjalë vajzash. Dëshira për dashuri ngrinte krye, lindnin ndjenja të reja.

Gjatë atyre udhëtimeve, edhe raportet mes nesh ndryshonin. Ato bëheshin më të afërta dhe më miqësore. Nuk ngurronim të flisnim edhe për gjëra intime, ose për probleme familjare. Miqësitë tona bëheshin më të forta, krijonim grupe shokësh, të cilët i zgjidhnim vetë sipas shijeve tona.

E parë nga jashtë, ndërtesa e shkollës dukej me tri kate. Në katin e parë, ku gjendeshin edhe banjat, rrinin zakonisht nxënësit e fillores dhe të tetëvjeçares, të cilët studionin për muzikë. Në katin e dytë kishte disa dhoma muzike përveç sallës së madhe të koncerteve, afër bibliotekës. Aty gjendeshin gjithashtu edhe klasat e fizikës dhe matematikës. Por hijen më të rëndë e kishte kabineti i letërsisë, të cilin Toka e kishte shumë për zemër. Ishte

një klasë ku mbizotëronte gjithmonë pastërtia dhe rregulli. Korridori i katit të dytë vazhdonte me shtesën e bërë enkas për ne të arteve figurative, e cila gjithnjë kundërmonte erë të rëndë terpentine dhe bojërash vaji. Ishin dhoma të bollshme ku ne, nxënësit e tri klasave të artit, studionim me orare. Dhomat, me drejtim nga jugu, rriheshin gjithmonë nga dielli, ishin plot dritë, arkitektët ia kishin përshtatur vendit si me magji, duke shfrytëzuar mrekullisht hapësirat mbi terracën e sallës së gjimnastikës. Nga njëri krah i saj, kur futeshe te klasa e Bobit, duhej të përshkoje tërë klasën ku zhvillohej mësimi, për të shkuar tek ajo e Letit. Ishin salla të mëdha studimi, të cilat ne i jetonim me një tension dhe përqendrim aq të madh gjatë punës krijuese, sa nuk e vinim re kush hynte dhe kush dilte.

Ndërsa, po të nxirrje kokën nga dritarja e korridorit të vogël, poshtë nesh, rrahur nga era e lagësht e veriut dhe me derën rrafsh me tokën, gjendej klasa e skulpturës. Aty ku shkohej duke i rënë shkollës përqark, jepte mësim profesor Lami.

Ishim tri klasa skulpture dhe çdo klasë kishte nga një grup. Çdo grup përbëhej nga shtatë vetë maksimumi, të cilët kishin edhe fizionominë e tyre.

Në klasën bri nesh, studionin ata që ishin një vit më të mëdhenj, të cilët na shihnin si nxënës ende të vegjël, prandaj na duhej shumë kohë, punë dhe lodhje për të arritur nivelin e tyre. Ngaqë ata kishin kaluar nga modelet në allçi, te figura e njeriut të gjallë, duke përvetësuar kështu edhe disa sekrete të zanatit, ata shpesh na shihnin nga lart-poshtë. Disa nga ata as nuk denjonin të na hidhnin sytë.

Më mendjemëdhenjtë, duke u mbllaçitur, na jepnin këshilla sikur të ishin mjeshtra. Por, kur futeshim tek ora e tyre, për të përfituar diçka nga vizatimet, a nga pikturat në vaj, mahnitësim vërtet nga niveli i disave.

Të gjithë po shkonim drejt maturës, ndaj në kokë fshehurazi na vërtitej veç një mendim torturues. Si e si të përgatiteshin sa më mirë për sfidën më të madhe, që na priste pas përfundimit të liceut artistik, konkursin për në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë.

Ishte ëndrra e fshehtë dhe që dukej si e paarritshme për gjithsecilin prej nesh. Edhe ata që e mohonin, që bënin si snobë dhe mospërfillës, e mendonin në fshehtësi. Në fund të fundit, ishte fare e natyrshme. Por e çuditshme ishte se, këtë ndjenjë inferioriteti që na e diktonin ata sipër nesh, “të diturit”, ne e shfrynim me nxënësit, të cilët ishin një vit poshtë nesh. Disa nga ata, çuditërisht ishin më të përgatitur se vetë ne, edhe pse ishin një vit më të vegjël. Ky ishte një tregues, se në art nuk kishte rregulla, as ligje të sakta. Më të talentuarit mund t’ua kalonin ndonjëherë edhe vetë mësuesve. Të lëvizshëm dhe plot gjallëri, ata ndoshta ishin edhe më brenda ëndrrës së madhe për t’u bërë artistë.

Shpesh, i habitur nga arritjet e tyre, bëja sikur i vështroja punët me mospërfillje. Natyrisht, ne ishim një vit më të mëdhenj, pra më të ditur. Ne dinim si sfumohej një hije, dinim ç’ ishte shprehja në vizatim, dinim ç’ ishte gjendja emocionale, dinim si të përziem ngjyrat dhe ç’ ishte zhërvjelltësia dhe plasticiteti në skulpturë. Ne kishim provuar gdhendjen në alabastër. Ndërsa ata ishin ende në fazën fillestare. Ende te Lulja me tri gjethe e allçisë. Te

Natyra e Qetë dhe te Dora apo Syri i Davidit. Si në vizatim, ashtu edhe në pikturë.

Në çdo klasë kishte tek-tuk edhe nxënës me një talent të spikatur. Nxënës që ecnin shumë përpara dhe i kalonin shokët e tyre. Jo të gjithë e donin mësimin e artit njëlloj. Kishte edhe nga ata nxënës që ishin gjendur aty rastësisht. Të tjerë sepse kishin pasur të njohur. Kishte nga ata që i ishin futur punës me mish e me shpirt, por nuk dolën artistë. Kish edhe nga ata që ishin të nivelit mesatar gjatë katër viteve të shkollës, por në jetë dolën mjeshtra të mëdhenj dhe bënë emër nëpër botë. Një pjesë, pra, vinin vërdallë tërë kohën, dhe vetëm gjatë orëve të fundit i viheshin punës që ta mbyllnin atë sa më shpejt. Si në vizatim, ashtu edhe në pikturë. Ndërsa kishte të tjerë, të cilët nuk i zinte gjumi nga dëshira e mirë për të dalë të parët në shkollë. Këta të fundit, më të zellshmit dhe punëtorët, ishin edhe më të apasionuarit. Ndërsa vajzat në përgjithësi nuk kishin ndonjë zjarr të madh në art. Dukej sikur e kishin mendjen më shumë të lyenin gishtat me manikyr, apo të llomotisnin fshehurazi për fustanet, muzikën dhe modën, sesa të shtroheshin në punë.

Ndërsa në katin sipër nesh, në të tretin, mbretëronin gjithkund veç tingujt. Korridori i gjatë, që ishte kryesisht i përbërë nga klasa të vogla, në dimër kridhej në errësirë. Por aty një kor pianosh, violinash, violonçelash, flautesh, apo klarinetash plekseshin mes tyre dhe e mposhtnin errësirën.

Ai korridor, gjithmonë i kredhur në errësirë, ishte edhe më i mistershmi, më i vështiri për t'u përshkuar. Por edhe më ëndërrndjellësi. Sidomos pasditeve, dhomat ishin përherë të mbushura me vajza të bukura, të cilat ose këndonin, ose, me

gishtat e tyre të hollë dhe të bukur, luanin me delikatesë mbi instrumentet e tyre.

Neve nxënësve të arteve figurative, që na binte puna të ngjiteshim sipër veç për furnizimet me sende shkollore, ideja e eksplorimit të katit të sipërm na grishte fort fantazinë. Vajzat e krehura bukur, me buzët dhe sytë si zana, për botën tonë me ngjyra ishin si pjesë e një galaktike tjetër. Të hijshme dhe të parfumosura, me sytë e tyre ëndërrimtarë dhe me buzëqeshjet misterioze, dukej sikur ato e ndriçonin krejt vendin. Çdonjëra ishte një botë më vete.

Ishte tejet intriguese dhe të ngjallte kureshtje, kur në dimër, pas shumë orësh lodhjeje nga puna me argjilën, ngjiteshim si kukudhë në errësirën e sallorit të gjatë. Zgjasnim qafat me kërshëri nëpër kuadratet e qelqeve të dhomave të tyre. Xhamat ishin të ndriçuar veç nga brenda dhe vajzat nuk na shihnin. Të bukura dhe me freskinë e moshës, ato hijeshonin gjithë ndërtesën. Nga ato vajza dolën këngëtare të mira si Morena Reka dhe të tjera që u dalluan si instrumentiste. Ndër djemtë u shquan violinistët Vlashi, Çezari, a Lukaçi.

Ndërsa në katin e parë, sapo hyje në të djathtë, gjendej një dhomë e vogël me dy shtretër hekuri. Shtretërit ishin vendosur njëri mbi tjetrin. Dhoma e shërbimit. Aty përnatë, sipas grafikut, një mësues edhe një nxënës bënë dezhurn për të ruajtur shkollën nga hajdutët dhe keqbërësit. Shtretërit me batanijet e errëta plot pluhur dhe erë të rëndë, të jepnin përshtypjen se gjendeshe në një repart të humbur ushtarak. Shërbimi ishte i detyrueshëm për të gjithë djemtë e shkollës. Ndaj, të paktën një herë në muaj, na pëlqente

apo jo, ne duhej të flinim në shkollë. Aty bënim shoqëri me hir apo me pahir me mësuesit dhe diskutonim me ta edhe për gjëra jashtë shkolle. Unë, ngaqë kisha një etje të paparë për njohuri arti, i lutesha planifikuesit të grafikut, të më vinte gjithmonë në të njëjtën natë me profesor Letin. Leti ishte një piktor durrsak plot shije, finesë dhe me një kulturë të paparë, sipas gjykimit tim prej djaloshi 16-vjeçar. Ai ishte një nga piktorët më të respektuar në qytet. Nip i Kolë Idromenos, ai kishte jo vetëm një talent të rrallë si piktor dhe ishte punëtor i madh, por ajo që më mahniste më shumë ishte kultura e gjerë në fushën e artit dhe oratoria e tij e veçantë. Kishte një stil tregimtar të bukur e plot zjarr. Si një Gogen i vërtetë, Leti bënte për vete gjithkënd nga ne nxënësit. Ishte jo vetëm një muhabetar i madh, por dinte si të mbillte në zemrat tona zjarrin për artin. “Kapela Sikstine. Është çudi, mor Tur! - thoshte Leti duke rrudhur ballin. - Nuk ka artist ta bëjë më atë lloj afresku!”, shtonte me bindje. Kur fliste plot energji dhe vrull lëvizte në ajër dorën e tij të madhe prej boksieri, sikur të donte ta vërtetonte edhe më me forcë bindjen e tij. Ndërsa kur shpjegonte gjëra të vogla apo detaje, Leti, me nofullat e gjera, shprehte të gjithë vitalitetin e tij prej artisti. Fliste gjithmonë duke picërruar sytë e zgjuar, mblidhte tre gishtat e dorës dhe i lëvizte me një kujdes ilustrues krejt origjinal. Dhe më pas zgjaste qafën e bëshme me vështrimin si të shqiponjës. Më mahniste gjithmonë pedagogjia e tij. Mënyra e të folurit ishte sa babaxhane, po aq edhe e tendosur dhe e prerë. Të qeshurën e kishte plot zhurmë, si një gjëmim topi dhe kur qeshte skuqej në fytyrë si lafshë gjeldeti.

Mund të them me plot bindjen se ai ishte shndërruar për shumë nga ne në një baba të mirë dhe të pazëvendësueshëm arti. Për të mos folur pastaj për qindra portretet në vaj, të cilat gjenden edhe sot e kësaj dite të shpërndara në qytetin e Durrësit. Ai ishte për ne mjeshtri, profesori, pedagogu, babai. Të flisje me Letin për pikturën, duke u futur në botën fantastike të artit, ishte sikur t’i futeshe në këmbë një pylli të dendur shpirtëror, plot me çudira dhe mrekulli, pastaj të dilje pas shumë orësh, krejt i rigjallëruar, me një pasion, entuziazëm dhe zjarr të ri për t’u marrë me art.

Nëpër netët e shërbimit, kur na takonte të rrinim bashkë, nuk flinim gati gjithë natën. Ai fliste me zjarr, unë e dëgjoja i mahnitur. Histori, ngjarje, komente punësh, shpjegime veprash, anekdota nga më të çuditshmet. Bisedat nuk kishin një rrjedhë kronologjike. Ato shpesh fillonin me çmendurinë komuniste, kur prishi veprat e artit nëpër kishat tona në vitin 1967. Pastaj dilte tek arti grek, romak, rilindja, e kështu me radhë deri sa vinte tek impresionistët dhe arti modern bashkëkohor. Për këtë të fundit, Leti, jo vetëm që nuk kishte respekt, por as nuk e pranonte fare si art serioz dhe të madh i cili do t’i rezistonte kohës.

“Arti do të rilindë Bakush!”, e kisha dëgjuar njëherë t’i thoshte plot bindje profesorit të anglishtes. Ishin te hyrja e shkollës atë pasdite dhe po debatonin së bashku me zjarr.

“Nuk rilind më arti, Let. Tani e ka në dorë fotografia. Imazhi. Filmi. Ato ia bënë gropën pikturës!”

“Arti do të rilindë. Mbaje mend fjalën time! - shtonte i sigurt Leti, duke picërruar sytë. - Njeriu ka nevojë për artin e vërtetë. Si buka që ha!” E kishte zërin e prerë dhe sytë blu aq të fortë, sa edhe dreqin do ta kishin ngrirë në ecje.